



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	20.04.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRASHCK	1906/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 131/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësi të procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 131/2021 të datës 11.03.2021, të parashtruar nga ankuesi _____ me adresë banimi në Rr. "Drenica" Kodra e Trimave, Prishtinë, kundër Ministrisë së Pushtetit Lokal, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe nenin 47 dhe 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.04.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet ankesa me numër A.nr.131/2021 e datës 11.03.2021, e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 111-160/2 i datës 01.03.2021 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 11.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1094/2021 të regjistruar me numër A.nr. 131/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.111-160/2 të datës 01.03.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJBN) të Ministrisë së Pushtetit Lokal.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 16.03.2021, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Pushtetit Lokal. Ndërsa Këshilli me datë 24.03.2021 ka pranuar nga Ministria e Pushtetit Lokal, përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1367/2021 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen meritore të çështjes ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1094/2021 të datës 11.03.2021, drejtuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 1181/2021, të datës

16.03.2021; Vendim me nr.111-160 i datës 22.02.2021; Ankesë kundër Vendimit 111-160 i datës 24.02.2021; Vendim me nr.111-160/2 i datës 01.03.2021; Kartel Identifikuese Zyrtar për Arkiv 4 i datës 06.11.2013; Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike për kategorinë Drejtues i Mesëm, i Ulët dhe Profesionalë i datës 21.01.2021; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë i datës 19.01.2021; E-mail nga M.Sh. për F.G. i datës 24.03.2021; E-mail nga B.D. për M.Sh. i datës 03.03.2021; E-mail nga Shkrimorja Mapl për F.G. i datës 22.03.2021; Përgjigje në kërkesën e KPMSHCK nr.1181/2021, me nr.111-160/4 i datës 22.03.2021; Kontrata e Marrëdhënies së Punës e datës 07.08.2006; Kërkesë për inicimin e procedurave të konkurrimit (lëvizje brenda kategorisë) i datës 16.12.2020; CV-ja e Diplomë me numër nr.D-12/2018 i datës 15.11.2018; Diplomë me numër nr. 1770 i datës 22.06.2004; Certifikatë prej datës 11 deri 22 Mars 2019; Certifikatë për pjesëmarrje në sesionet e edukimit jo-formal në filozofinë Politike në kuadër të Projektit " Trajnim për të rinjtë e Prishtinës", mbështetur financiarisht nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Vërtetim i datës 09.02.2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2019; E-mail nga B.D. për M.Sh. i datës 03.03.2021; Vendim me nr.111-1236/5 i datës 18.12.2018; E-mail nga C.Z. për M.Sh. i datës 12.04.2021; E-mail nga B.P. për C.Z. i datës 13.04.2021; E-mail nga M.Sh. për B.P. i datës 13.04.2021; E-mail nga Shkrimorja Mapl për B.H. i datës 22.02.2021; E-mail nga Shkrimorja Mapl për B.H. i datës 01.03.2021; E-mail nga M.Sh. për C.Z. i datës 20.04.2021; Njoftimi i MAP/MPB i datës 13.01.2021; Njoftimi për shpalljen e Konkursit prej datës 04.02.2021 deri 12.02.2021;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Ministria e Pushtetit Lokal me datë 19.01.2021 ka shpallur Konkursin me nr. Ref.RN00006234 për lëvizje brenda kategorisë në pozitën "Zyrtar për Koordinim të Politikave" në Divizionin për Koordinim të Politikave, e në të cilin konkurs ka aplikuar vetëm ankuesi.Divizioni i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal, në fazën e verifikimit paraprak, me Vendimin numër 111-160 të datës 22.02.2021 ka njoftuar ankuesin se nuk ka plotësuar kushtet e paparapara me konkursin për pozitën " Zyrtar për Koordinim të Politikave, me arsyetim se ankuesi ka pozitën Korrier-nëpunës administrativ-mbështetës dhe nuk plotëson kushtin për lëvizje brenda kategorisë. Ankuesi i pa kënaqur me këtë vendim, me datë 24.02.2021 ka ushtruar ankesë pranë Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal, ku kjo e fundit me Vendimin me numër 111-160/2 të datës 01.03.2021 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të Njesisë së Burimeve Njerëzore (NJB) me Nr.111-160/2 të datës 01.03.2021 të Ministrisë së Pushtetit Lokal, me pretendimet ankimore se vendimi i kundërshtuar është nxjerrë me shkelje të dispozitave procedurale dhe materiale të legjislacionit të zbatueshëm gjegjësisht Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civilë duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit numër 111-160/2 të datës 01.03.2021 të Njesisë së Burimeve Njerëzore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 39 ku është përcaktuar se: 1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij

neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nën paragrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nenin 40 paragrafi 3 ku shprehimisht thuhet: *Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë është i mbyllur dhe në të kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil*, dhe si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se pozitat e lira në shërbim civil të nivelit profesional dhe nivelit drejtues të ulët dhe të mesëm, fillimisht, duhet të plotësohen përmes procedurës së lëvizjes brenda kategorisë së njëjtë, në të cilën procedurë të drejtë aplikimi kanë vetëm nëpunës civilë të së njëjtës kategori, e që mund të jenë nëpunës të punësuar pranë institucionit që shpall konkursin apo edhe në institucionin tjetër publik.

Nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se konkursi me nr. Ref RN00006234 për lëvizje brenda kategorisë në pozitën "Zyrtar për Koordinim të Politikave", është shpallur në pajtim me nenin 43 lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht konkursi është shpallur me datë 19.01.2021 në Sistemin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe në webfaqen e Ministrisë së Pushtetit Lokal. Shpallja është bërë 15 ditë para afatit të përcaktuar për pranimin e aplikacioneve nga kandidatët, ndërsa afati i aplikimit ka qenë i hapur nga data 04.02.2021 deri me 12.02.2021, si dhe konkursi ka përmbajtur të gjitha të dhënat e përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 43 të kësaj Rregullore.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka vlerësuar se Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal me rastin e njoftimit të ankuesit në fazën e verifikimit paraprak se nuk ka plotësuar kushtet e parapara me konkursin për pozitën "Zyrtar për Koordinim të Politikave", ka vepruar në pajtim me nenin 41 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 dhe nenin 45 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse bazuar në dosjen e aplikimit gjegjësisht Ndryshim dhe Plotësim Aktit të Emërimit të datës 05.11.2013, ankuesi është i punësuar në pozitën e "Korrierit" në Departamentin për Administratë dhe Financa në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, e cila pozitë e punës bazuar në dispozitat e nenit 2 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil por hyn në kategorinë e nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës ashtu siç është përcaktuar me nenin 2 paragrafi 6 të këtij Ligji ku thuhet se: *Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.*

Andaj, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në nenin 41 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku është përcaktuar se: *2.Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon*, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Pushtetit Lokal, me vendimin e atakuar me ankesë ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike, sepse ankuesi nuk ka plotësuar kushtin bazë për aplikim për pozitën Zyrtar për Koordinim të Politikave në Ministrinë e Pushtetit Lokal, e mbi këtë bazë rrjedhë se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pa bazuara.


Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga kryetarja e kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 131/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Pushtetit Lokal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Pushtetit Lokal; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

